

EC
MA NDRYSHE

Hapësirat

Publike

Gjelbëruese
në Gjakovë

SUSTAINABLE
DEVELOPMENT
GOALS



Sweden
Sverige





HAPËSIRAT PUBLIKE GJELBËRUESE NË GJAKOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Adresa: Rr. Fehmi Lladrovci 94,
Prizren, Bulevardi Nënë Tereza, H 30
B1 Nr.5, 10000 Prishtinë
Kontakti: www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Hulumtimi "Hapësirat publike gjelbëruese në Gjakovë" është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj "Human Rightivism" që implementohet nga Community Development Fund – CDF.

Përbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.



HYRJA

Hapësirat publike janë pjesë të pandashme të një qyteti funksional. Këto hapësira duhet të jenë të planifikuara në bashkëpunim me komunitetin që banon në ato zona në mënyrë që të jenë përmbushëse ndaj nevojave të të gjithë grupeve përbërëse, specifikisht të atyre kategorive që janë pjesë të ndjeshme të shoqërisë.

Hapësirat e gjelbra brenda zonave urbane e rrisin cilësinë e qytetit dhe promovojnë një jetesë të qëndrueshme sepse e përmirësojnë shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve.


EC Ma Ndryshe ka realizuar një hulumtim mbi gjendjen e hapësirave publike në qytetin e Gjakovës. Të përshtirë në këtë hulumtim kanë qenë qytetarët e këtij qyteti dhe gjithsej janë realizuar 100 pyetësorë, në lagjet:

- Parku "Ali Podrimja"
- Blloku i Ri
- Çabrat
- Çarshia e Vjetër
- Lagjja e Hankës
- Lagjja e Gecës
- Piskotë
- Lagjja e Hadumit
- Lagjja e Haxhi Ymerit
- Lagjja e Kusarëve
- Lagjja Qerim
- Lagjja e Spitalit
- Lagjja e Sefës
- Lagjja Mulla Jusuf
- Qendra Historike
- Lagjja e Cullakëve
- Taphone


Hulumtimi ka për qëllim që të analizojë gjendjen ekzistuese të hapësirave publike si dhe ngrit si çështje praninë dhe kualitetin e mobiliarit urban në hapësirat publike në këndvështrimin e qytetarëve, pjesëmarrjen e tyre në diskutime publike dhe çështje të tjera.

Përfundimet e nxjerra nga ky hulumtim përshkruhen në pjesën e fundit ku renditen edhe rekomandimet se si këto hapësira do të ngrisin cilësinë e jetës dhe do të ishin më të shfrytëzueshme nga banorët e këtij vendi.


SA SHPESH I FREKUENTONI PARQET PUBLIKE?




A MENDONI SE KA MJAFTUESHËM HAPËSIRA PUBLIKE TË GJELBËRUARA NË QYTET?




A JANË TË MJAFTUESHME DHE TË MIRËMBAJTURA ULËSET NËPËR PARQE DHE HAPËSIRA PUBLIKE?



CILA PJESE/LAGJE E QYTETIT MENDONI QE KA NEVOJË PER HAPESIRA GJELBERUESE/PARK?



A MENDONI SE KA MJAFTUESHËM SHPORTA DHE KONTEINER PËR MBETURINA NË PARQET DHE HAPËSIRAT PUBLIKE DHE A MIRËBAHEN NGA INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE?



A KA KËND TË LOJËRAVE PËR FËMIJË NË PARKUN E LAGJES TUAJ?



SA MENDONI SE KA NEVOJË QYTETI I GJAKOVËS PËR SHTIGJE TË BIÇIKLETAVE?

A) SHUMË, SEPSE GJAKOVA NUK KA HAPËSIRË ADEKUATE PËR BIÇIKLETA

70%

B) MESATARISHT, SEPSE NË GJAKOVË EKZISTOJNË DISA HAPËSIRA TË DEDIKUARA PËR SHFRYTËZIM TË BIÇIKLETAVE

27%

C) ASPAK, SEPSE GJAKOVA KËMBAKA MJAFTUESHËM SHTIGJE PËR BIÇIKLETA

3%

A MENDONI SE KRIJIMI I SHTIGJEVE/RRUGËVE PËR BIÇIKLETA NËPËR QYTET DO TA SHTONTE PËRDORIMIN E BIÇIKLETAVE SI MJET TRANSPORTUES?

A) SHUMË

68%


B) MESATARISHT

29%


C) ASPAK

1%


ARTI PUBLIK NDIHMON NË RRIJEN E SHFRYTËZUESH-MËRISË SË HAPËSIRAVE PUBLIKE (MURALE, VIZATIME...)?




A MENDONI SE LAGJJA JUAJ KA HAPËSIRA POTENCIALE PËR ZHVILLIMIN E ARTIT PUBLIK (MURALE, VIZATIME...)?




A KUJDESEN BANORËT E LAGJES PËR MIRËMBAJTJEN E PARKUT DHE HAPËSIRAVE PUBLIKE?




A MENDONI SE NDRIÇIMI NË PARQE DHE HAPËSIRA PUBLIKE ËSHTË I MJAFTUESHËM?




A MENDONI SE PARQET DHE HAPËSIRAT PUBLIKE JANË TË SIGURTA PËR VAJZAT/GRATË?




A JANË TË QASSHME PARQET DHE HAPËSIRAT PUBLIKE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA?



A EKZISTON RREZIKU NGA QENTË ENDACAK NË PARKUN E LAGJES DHE HAPËSIRAT PUBLIKE?



A JANË TË QASSHME PARQET DHE HAPËSIRAT PUBLIKE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA?



PËRFUNDIME

Bazuar në këtë hulumtim dhe analizë mbi gjendjen e hapësirave publike në Gjakovë, mund të përfundojmë se ka disa mangësi të theksuara. Mobileria urbane; shportat e mbeturinave, ulëset, janë jo shumë të shfrytëzueshme nga ana e qytetarëve sepse ato janë të pamjaftueshme e edhe në rastet kur në disa vende ka të tilla, ato nuk kanë mirëmbajtje. E poashtu në cilësi jo të mirë është edhe ndriçimi publik, shtigjet e bicikletave që konsiderohen shumë të mangëta si dhe infrastruktura-qasja për persona më aftësi të kufizuara.

- Nga qytetarët e anketuar në Komunën e Gjakovës, 41% kanë potencuar që parqet publike nga ata vizitohen shpesh, 29 % e tyre kanë potencuar që ato vizitohen rrallë, 27% kanë potencuar që vizitohen rregullisht kurse 3% e tyre kanë potencuar që ato nuk vizitohen asnjëherë.
- Vetëm 2% e qytetarëve janë të mendimit që hapësirat publike gjelbëruese në Gjakovë janë të mjaftueshme, deri sa 35% janë të mendimit që ka nevojë për më shumë hapësira gjelbëruese, 41% mendojnë që ka nevojë për më shumë dhe që nuk ka fare mendojnë 22% e tyre.
- Sipas qytetarëve, lagija "Blloku i Ri" është pjesa e qytetit e cila ka nevojë më së shumti për hapësira gjelbëruese, saktësisht 25.64% e tyre, duke lënë pas qendrën e qytetit me 8.97% e Lagjja e Gecës dhe e Hadumit me 6.41% dhe në një përqindje më të vogël lagjet e tjera të qytetit.
- 55% e të anketuarve potencojnë që ulëset nëpër parqe dhe hapësira publike në qytetin e Gjakovës nuk janë të mjaftueshme, deri sa 39% e tyre mendojnë se janë të mjaftueshme në sasi mirëpo janë në gjendje jo të mirë (janë të dëmtuara), kurse një përqindje e vogël mendojnë se ato janë të mjaftueshme e janë në nivel të duhur (vetëm 6% e tyre). Poashtu shqetësim tjetër i qytetarëve është edhe mungesa e shportave dhe kontejnerëve si dhe mirëmbajtja e tyre nga institucionet përgjegjëse. 60% e tyre e kanë ngritur si çështje mungesën e shportave në hapësira publike deri sa 34% e tyre kanë potencuar që shportat në sasi janë të mjaftueshme por nuk mirëmbahen. E në përqindje më të vogël (6%) janë të mendimit se shportat dhe kontejnerët janë të mjaftueshme dhe të mirëmbajtura.
- 73% e qytetarëve kanë potencuar që janë shumë të mangëta këndet e lojërave për fëmijë në parqet e lagjeve në Gjakovë. 17% kanë potencuar që kënde ka por nuk janë të mirëmbajtura, kurse 10% i kanë vlerësuar të mjaftueshme dhe në gjendje të mirë.

- Sa i përket shtigjeve për bicikleta, 70% e qytetarëve mendojnë që ka nevojë shumë pér to, kurse 27% janë të mendimit mesatar dhe 3% i shohin të panevojshme shtigjet. Sipas 68% të qytetarëve, krijimi i shtigjeve do ta shtonte përdorimin e bicikletave si mjet transporti.
- 51% e qytetarëve e kanë shprehur fuqishëm mendimin e tyre se arti publik ndihmon në rritjen e shfrytëzueshmërisë së hapësirave publike, derisa 38% janë pjesërisht të këtij mendimi dhe 9% nuk janë fare të këtij mendimi. Ndërsa sa i përket hapësirave potenciale pér zhvillimin e artit publik, 37% e qytetarëve mendojnë që në lagjet e tyre këto hapësira janë të mjaftueshme, 35% e tyre mendojnë që nuk janë të mjaftueshme dhe 27% e tyre mendojnë që nuk ka hapësira potenciale fare në lagjet e tyre.
- Sa i përket kujdesit të banorëve të lagjes pér mirëmbajtjen e parkut dhe hapësirave publike, shumica e qytetarëve (51%) kanë potencuar që këto parqe mirëmbahen ndonjëherë (jo vazhdimesh), 27% që ata nuk kujdesen fare, kurse vetëm 21% mendojnë që parqet mirëmbahen nga banorët.
- Ndriçimi në parqe dhe hapësira publike sipas shumicës së qytetarëve (65% prej tyre) e vlerësojnë në nivel jo të mirë (deri diku), 10 % e vlerësojnë në cilësi të mirë e të mjaftueshme, kurse 24% e vlerësojnë në cilësi jo të mirë.
- Nga 100 të anketuar, 33% e tyre mendojnë që hapësirat publike janë të sigura pér vajzat/gratë, 18% i vlerësojnë fare të sigura këto hapësira kurse 48% i vlerësojnë si deri diku të sigurta.
- Qasja pér Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK) nëpër hapësira publike vazhdon të mbetet shqetësim. 43% e të anketuarve vlerësojnë se këto hapësira janë pjesërisht të qasshme, e në përqindje të njëjtë qytetarët kanë potencuar që ato janë të qasshme vetëm me përcjellje.
- 81% e qytetarëve të anketuar janë të shqetësuar pér rrezikun nga qentë endacak, kurse 18% e tyre kanë potencuar që nuk paraqitet rrezik nga këta të fundit.
- 89% e qytetarëve kanë potencuar që qytetarët nuk janë ftuar asnjëherë nga institucionet komunale pér të diskutuar dhe ofruar propozime rreth hapësirave gjelbëruese në qytet, 7% kanë potencuar që janë ftuar por nuk kanë marrë pjesë, kurse 3% kanë potencuar që janë ftuar dhe kanë marrë pjesë.

REKOMANDIME

Hapësirat publike duhet të janë funksionale si dhe të janë të qasshme për të gjitha grupet e shoqërisë. Mungesa e ulëseve dhe shporta të mbeturinave në numrin dhe nivelin e duhur, e bën pothuajse të pamundur shfrytëzimin e hapësirave publike. Duke u bazuar në statistikat e nxjerra, ne rekomandojmë që ulëset dhe shportat e mbeturinave që janë ekzistente, të mirëmbahen nga organet përgjegjëse, dhe sipas nevojës të shtohen aty ku janë të nevojshme.

Rekomandojmë që Komuna ta krijojë një plan të mobilitetit përmes të cilit të shtohen parkingjet dhe shtigjet për bicikleta, në mënyrë që qytetarëve t'iua krijuhet hapësirë për eleminim të përdorimit të veturave e në vend të tyre të kenë alternativën e bicikletës për transport.

Rekomandohen institucionet kompetente që të vazhdojnë me konsultime publike me qytetarët e Gjakovës si dhe sugjerojen që të organizojnë takime mes banorëve dhe planerëve në mënyrë që identifikimi i hapësirave për intervenime të jetë i bazuar direkt në kërkesat e qytetarëve.

Bazuar në të dhënrat e mbledhura mund të konkludojmë se në parqet dhe lagjet e qytetit të Gjakovës nuk ka ndriçim të mjaftueshëm. Ndriçimi jo i mirë mund të rezultojë edhe me cënimin e sigurisë publike. Rritja e kualitetit të ndriçimit apo dhe rritja e sasisë së ndriçuesve nëpër hapësira të nevojshme do të ndihmonte dukshëm në zbutjen e këtyre problemeve. Rekomandohet që institucionet relevante të tregohen më të gatshëm edhe për sigurimin e mjeteve për trajtimin e qenve, duke filluar nga kapja, e deri tek strehimi i tyre në strehimore.

Personat me Aftësi të Kufizuara në Kosovë në përgjithësi, e edhe në Gjakovë në veçanti përballen me diskriminimin shumëdimensional në baza ditore. Komuna duhet të zbatojë hapa të përgjithshëm për të siguruar një qytet pa bariera sepse sipas statistikave të nxjerra, personave me aftësi të kufizuara dukshëm ju mungon pavarësia në lëvizje të lirë.

Planifikimi me pjesëmarrje siguron që asnjë nga grupet e komuniteteve të mos janë të përjashtuara nga zhvillimet në shoqëri, meqë hapësira e ndërtuar falë procesit të tillë, promovon lëvizje të lirë, zhvillim, punësim, arsim dhe në përgjithësi barazi sociale.

PËR EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqëyrjes së vendimmarres publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: 1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshmë statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, 2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe 3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente: **1.** Gjithëpërfshirjen, **2.** Qëndrueshmërinë, dhe **3.** Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbashëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizonare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

- 1. Paanshmëria** - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpërra alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të janë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsjon;
- 2. Aktivizmi** - Anëtarët e EC do të janë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpërra bashkëveprimin qytetar për të përbushur misionin e organizatës;
- 3. Orientimi drejt rezultateve** - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
- 4. Komuniteti bazë e veprimit** - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.